

## NË EMER TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit I. H. nga fshati ..... Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale ndotja, degradimi dhe shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par.1 të KPK, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.1156/2014 të datës 12.02.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në praninë e Prokurorit të Shtetit Sahide Sefa, të akuzuarit, mbrojtësit të tij avokat E. G. nga Prizreni dhe përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarës KPMM inxhinieri i xehetarisë – inspektori Nasuf Mirena nga Prishtina, me datë 16.02.2016 publikisht morri dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**I. H.** nga i ati D. dhe e ëma Gj. e lindur G., i lindur më datë “data e lindjes..” në fshatin ..... Komuna e Prizrenit ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, automekanik, pronar i kompanisë SH.P.K. “... ..” me seli në fshatin ..... , i martuar, baba i katër fëmijëve, me numër personal ..... , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike.

### ËSHTË FAJTOR

Se me datë 24.10.2013 në fshatin ..... Komuna e Prizrenit, si pronar i kompanisë SHPK “.... ..” shfrytëzon jashtë mase burimet natyrore dhe atë duke operuar ilegalisht në përpunimin, seperimin e resurseve të mineraleve, në atë mënyrë që ka ushtruar aktivitet të pa ligjshëm pa u pajisur me leje për aktivitet e veçanta seperacioni dhe lloji i mineralit që ishte duke seperuar ishte rërë dhe zhavorr, me të cilin veprim Ministrisë së Energjisë dhe Mineraleve – Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale i shkakton dëm material në shumë prej 5000 € (pesë mijë euro).

**Këso dore ka kryer veprën penale ndotja, degradimi dhe shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par.1 të KPK.**

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 46, 73 dhe nenit 347 par.1 të KPK të akuzuarit ia shqipton:

### DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 300 € (treqind euro) e cila shumë duhet të paguhet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet në afat ligjor i njëjti do të zëvendësohet me 15 (pesëmbëdhjetë) ditë dënim burgu duke llogaritur 20 € për një ditë burg.

E dëmtuara Ministria e Energjisë dhe Minierave në Prishtinë nëpërmjet autorizuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën me numër PP/II.nr.1156/2014 të datës 12.02.2015 kundër të akuzuarit I.H. nga fshati ..... Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale ndotja, degradimi dhe shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par.1 të KPK.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit Sahide Sefa ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës së parashtruar nën numrin PP/II.nr.1156/2014 të datës 12.02.2015, kundër të akuzuarit I. H. , për shkak të veprës penale ndotja, degradimi dhe shkatërrimi nga neni 347 par.1 të KPK. Në shqyrtimin gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet dhe atë nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuarit i cili është në pajtim me provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Andaj propozoj gjykatës që të njëjtën ta shpall fajtor dhe të dënoj në bazë të ligjit.

Përfaqësuesi i autorizuar i KPMM – inspektori Nasuf Mirena deklaroi si palë e dëmtuar parashtron kërkesë pasurore juridike për vlerën e cila është cekur në dispozitiv të aktakuzës.

Mbrojtësi i akuzuarit avokati E. G. në fjalën përfundimtare deklaroi pas që i mbrojturi i tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka pranuar fajësinë për veprën penale objekt i akuzës, mbrojtësi nga gjykata kërkoj gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ta ketë parasysht të gjitha rrethanat lehtësuese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, premtori se në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e këtilla andaj propozoj gjykatës që ndaj të mbrojturit të tij të shqiptoj një dënim me kusht sepse edhe me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit.

I akuzuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e përkrah fjalët e mbrojtësit të tij dhe premtori para gjykatës se në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e këtilla në mënyrë që mos të bie ndesh me ligjin.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Ditën kritike me datë 24.10.2013 në fshatin ..... Komuna e Prizrenit, në kompaninë SHPK “.... ” pronar i të cilit është i akuzuari I. H., shfrytëzon jashtë mase burimet natyrore, operon ilegalisht në përpunimin, seperimin e resurseve të mineraleve, në atë mënyrë që ushtron aktivitet të pa ligjshëm pa u pajisur me leje për aktivitet e veçanta seperacioni për llojin e mineralit që ishte duke seperuar ishte rërë dhe zhavorr, me të cilin veprim Ministrisë së Energjisë dhe Mineraleve – Komisionit të Pavarur për Minjera dhe Minerale i shkakton dëm material në shumë prej 5000 € (pesë mijë euro).

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga provat materiale, provat tjera të cilat janë pjesë e shkresave të lëndës dhe nga pranimin vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuarit, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe plotësisht në pajtim me provat të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me kohë. Prandaj gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 246 të KPPK, kështu që në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale ndotja, degradimi dhe shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par.1 të KPK dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese, si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendim i thellë, deri më tani asnjëherë nuk ka ra ndesh me rregullat e pozitive, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me gjobë sepse konsideron se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarit në kontest të rregullt civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marr konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marr në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat me lart është vendosur si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.270/2015 të datës 16.02.2016**

**Procesmbajtësja**  
**Myrvete Përdibuka**

**Gjyqtarja**  
**Teuta Krusha**

**KESHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.